

HydroEnergy Sh.p.k
Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018



HYDROENERGY Sh.p.k
Rr Kavajes Dalje Kombinat
Vaqarr (Tirana) ALBANIA

6

Përmbajtja

Raporti i Auditimit	3-5
Pasqyra e Pozicionit Financiar	6
Pasqyra e Performancës	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto	8
Pasqyra e Rrjedhjes së Mjeteve Monetare	9
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	10-22



HYDROENERGY Sh.p.k
Rr Kavajes Dalje Kombinat
Vaqarr (Tirana) ALBANIA

Raport i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Pronarit dhe Drejtimit të HydroEnergy Sh.p.k

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të HydroEnergy Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018 dhe pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e rrjedhjes së mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2018 si edhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhën e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").


Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Palëve të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazaë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinionin mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyestuehmërinë, e çmuarjeve kontabël si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.



Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me drejtimin e HydroEnergy Sh.p.k, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditues ligjor
Margarita Kalemasi

01 Mars 2019
Tiranë, Shqipëri



Rr. Asim Vokshi
Nd. 14, H. 6, Ap. 27
Kod Postar 1016
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 242 0666
m.kalemasi@joncon.al

A handwritten signature in the bottom right corner of the page.

HydroEnergy sh.p.k

Pasqyra e Performancës për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Pozicionit Financiar


AKTIVET	Shënimi	31/12/2018	31/12/2017
Aktivet Afatgjata			
Toka dhe ndërtesa	4	67,704,348	67,704,348
Makineri dhe mjete transporti	4	1,949,495,501	1,979,584,315
Të tjera instalime dhe pajisje	4	1,974,136	1,117,831
Totali i Aktiveve Afatgjata		2,019,173,985	2,048,406,494
Aktivet Afatshkurtra			
Para në arkë dhe bankë	5	27,326,636	10,435,827
Llogari të arkëtueshme, klientë	6	16,378,088	36,548,270
Llogari të tjera të arkëtueshme	7	245,186,694	260,779,505
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		288,891,417	307,763,602
TOTALI I AKTIVEVE		2,308,065,402	2,356,170,096
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Kapitali			
Kapitali i paguar	8	1,444,108,950	1,444,108,950
Rezerva	9	19,991,264	19,991,264
Humbje e akumuluar		(325,667,156)	(246,738,927)
Fitim / Humbja e Vitit		46,762,063	(78,928,229)
TOTALI I KAPITALIT		1,185,195,121	1,138,433,059
Detyrimet Afatshkurtra			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	10	178,104,707	159,063,922
Detyrime të tjera afatshkurtra	11	532,040	921,079
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		178,636,747	159,985,001
Detyrimet Afatgjata			
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	12	944,233,533	1,057,752,036
Totali i Detyrimeve Afatgjata		944,233,533	1,057,752,036
TOTALI I DETYRIMEVE		1,122,870,280	1,217,737,037
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,308,065,402	2,356,170,096

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 10 – 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga drejtimi më 28 shkurt 2019 dhe firmosur nga:

Hartuese e Pasqyrave
Mejtina Kamberi

Financiare Drejtor Ekzekutiv
Dott. Giovanni Annoni
Dott. Matteo Fumagalli Romario





HydroEnergy sh.p.k

Pasqyra e Performancës për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Performancës

	Shënimi	31/12/2018	31/12/2017
Të ardhurat			
Të ardhurat	13	152,348,000	119,106,358
Shpenzime operative			
Shpenzime për punonjësit	14	(5,359,765)	(6,120,425)
Shpenzime administrative	15	(13,236,066)	(20,898,048)
Shpenzime amortizimi	4	(100,318,467)	(104,589,820)
Totali i shpenzimeve operative		(118,914,298)	(131,608,293)
Shpenzimet financiare neto			
Fitime nga kurset e këmbimit	16	83,457,345	22,910,306
Shpenzime për interesat	16	(70,128,984)	(89,336,600)
		13,328,361	(66,426,293)
Humbja para tatimit	17	46,762,062	(78,928,229)
Shpenzimi për tatim fitimin			
FITIMI / HUMBJA NETO E VITIT		46,762,062	(78,928,229)

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 10 – 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



HydroEnergy sh.p.k

Pasqyra e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksionar	Rezerva	Humbje të mbartura	Fitim / (humbje)	Total
Pozicioni financiar më 01.01.2017	228,928,950	19,991,264	(143,556,986)	(103,181,943)	2,181,286
Emetim i kapitalit	1,215,180,000				1,215,180,000
Humbje e vitit			(78,928,229)		
Pozicioni financiar më 31.12.2017	1,444,108,950	19,991,264	(143,556,986)	(182,110,172)	1,138,433,057
Emetim i kapitalit					-
Fitimi i vitit				46,762,062	46,762,062
Pozicioni financiar më 31.12.2018	1,444,108,950	19,991,264	(143,556,986)	(135,348,110)	1,185,195,119

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në 10 – 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

HydroEnergy sh.p.k

Pasqyra e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Rrjedhjes së Mjeteve Monetare

	Shënim	31/12/2018	31/12/2017
AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT			
Fitim / (humbja) neto e vitit		46,762,062	(78,928,229)
Rregullime për:			
Zhvlerësim dhe amortizim	4	100,318,467	104,589,820
Ndryshime në:			
- inventarë		-	-
- llogari të arkëtueshme	6,7	35,762,994	15,657,730
- llogari të pagueshme	10,11	18,651,746	(1,633,596,477)
Fluksi i parasë neto gjeneruar nga aktivitetet operative		201,495,269	(1,592,277,156)
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE INVESTUESE			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	4	(71,085,958)	(1,165,500)
Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet investuese		(71,085,958)	(1,165,500)
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE FINANCUESE			
Rritja e kapitalit aksionar	8	-	1,215,180,000
Pagesa e huave	12	(113,518,503)	282,699,155
Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet financuese		(113,518,503)	1,497,879,155
Rritje neto në para dhe ekuivalentët	5	16,890,809	(95,563,499)
Para dhe ekuivalentët në fillim të vitit	5	10,435,827	105,999,326
Para dhe ekuivalentët në fund të vitit	5	27,326,636	10,435,827

Pasqyra e rrjedhjes së mjeteve monetare duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 10 – 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



HYDROENERGY Sh.p.k
Rr Kavajes Dajë Kombinat
Vaçarr (Tiranë) ALBANIA

HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

HydroEnergy Sh.p.k (“Shoqëria”) është një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar në Shqipëri. Adresa e Shoqërisë është Rruga e Kavajës, Vaqarr, Tiranë, Shqipëri. HydroEnergy Sh.p.k është regjistruar në datën 27 Mars 2009 në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS K91527017E dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shoqëria fillimisht është regjistruar si shoqëri konçesionare nga Euro-AL Sh.p.k dhe Energysolution Sh.p.k dhe u përfshi në një marrëveshje konçesionare BOT me objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve Murdhari 1 dhe Murdhari 2 në komunat Krrabë dhe Ibë.

Pas transferimit të aksioneve nga Energysolution Sh.p.k tek SOL S.p.A në qershor të vitit 2009, aktualisht Shoqëria zotërohet nga SOL dhe Euro-AL me 96.04% dhe 3.96% të kapitalit respektivisht.

Drejtimesit e Shoqërisë janë Z. Giovanni Annoni dhe Z. Matteo Fumagalli Romario.

Marrëveshja Konçesionare – Terma të rëndësishëm

Sipas nenit 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 9663 “Për Konçesionet” i datës 18.12.2006, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 310 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me konçesion të hidrocentralit “Murdhari 1”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konçesionare, që i jepet shoqërisë” i datës 26.03.2008, u nënshkrua marrëveshja konçesionare ndërmjet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës – METE (aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë – MEI) dhe Bashkimi i përkohshëm i Shoqërive “Euro-AL” Sh.p.k dhe “Energysolution” Sh.p.k si Shoqëria Konçesionare për financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve “Murdhari 1” dhe “Murdhari 2” dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues.

Sipas Marrëveshjes Konçesionare, Shoqëria do të ndërtojë dy njësi prodhuese hidroenergjitike (Murdhari 1 dhe Murdhari 2) me një fuqi të instaluar 2680 kW dhe 1000kW dhe me një prodhim energjie elektrike 10566570 kWh dhe 4195400 kWh respektivisht.

Marrëveshja është e organizuar si një model projekti i tipit BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një periudhë fillestare prej 35 vjetësh nga data efektive.

HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM (vazhdim)

Marrëveshja Konçesionare – Terma të rëndësishëm (vazhdim)

Pas kësaj periudhe, pronësia e hidrocentraleve do t'i transferohet MEI (më parë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës-METE) pa asnjë tarifë, bashkë me pajisjet e operimit, të drejtat e garantuara dhe kontratat.

Aktiviteti tregtar i Shoqërisë mbështetet nga Licencat e mëposhtme të dhëna nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE):

- Licenca për Prodhimin e Energjisë Elektrike Nr. 96, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 25 të datës 29.03.2010 me afat 30 vjet;
- Licenca për Tregtimin e Energjisë Elektrike Nr. 107, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 59 të datës 08.09.2010 me afat 30 vjet.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.



HYDROENERGY Sh.p.k
Rr Kavajes Dalje Kombinat
Vaqarr (Tirana) ALBANIA

HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen përgjithësisht në fitime ose humbje.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.10
1 GBP	137.42	149.95

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anulohen.



HYDROENERGY Sh.p.k
Rr Kavajes Dalje Kombinat
Vaqarr (Tirana) ALBANIA

HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Mjetet monetare dhe ekuivalentët t tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtaave të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

3.3 Aktivët afatgjatë materiale

Njohja dhe matja

Aktivët afatgjatë materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimin e tokës në gjendjen origjinale. Programet (software) e blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisjeje. Kur pjesë të një aktiviteti material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si të ndara (pjesë të rëndësishme). Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë aktiviteti përcaktohen duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktivitetit dhe pasqyrohen neto në zërin të ardhura të tjera të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjatë të trupëzuara i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të



HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve ditore të aktiveve afatgjata të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të shpërndarë koston e aktiveve minus vlerën e tyre të mbetur gjatë jetës së dobishme dhe përgjithësisht njihet në të ardhura dhe shpenzime. Përmirësimet e ambienteve me qira amortizohen përgjatë afatit të qirasë. Aktivët në proces nuk amortizohen.

Jeta e dobishme e vlerësuar, normat e amortizimit të vitit dhe metodat e paraqitura më poshtë, janë zbatuar për periudhën aktuale dhe atë krahasuese.

• Toka	Nuk amortizohet
• Ndërtesa, rrugë etj.	5 %
• Pajisjet dhe makineritë	20%
• Automjete	20%
• Pajisje Zyre & Informatike	20 – 25%

3.4 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të vlerësohet me besueshmëri dhe do të kërkojë flukse dalëse monetare të ardhshme për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset monetare të ardhshme të pritshme me një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.5 Njohja e të ardhurave

Shoqëria është e përfshirë në tregëtimin e energjisë elektrike. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet nga pronësia i janë transferuar klientit, rimarrja e shumës është e mundëshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të vlerësohen me besueshmëri dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për tu arkëtuar, neto nga kthimet. Për shitjen e energjisë, transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve ndodh kur sasia aktuale e energjisë hidhet në rrjet dhe matet në pikën e shpërndarjes.

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në fitime ose humbje. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesat nga huatë dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.



Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar nga të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të bërë të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin, nëse ka. Ky tatim llogaritet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit. Tatim fitimi aktual përfshin gjithashtu çdo tatim që rezulton nga dividendët. Tatim fitimi aktual i pagueshëm ose i arkëtueshëm kompensohen vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjen tatimore të papërdorur, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferenca të përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të realizohet. Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatimor përmirësohet.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferenca të përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivit tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyre vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

4. AKTIVET AFATGJATA

Aktivet materiale	Tokat	Makineri dhe mjete transporti		Pajisje Informatike	Totali
<i>Kosto</i>					
Më 1 janar 2017	66,538,848	2,390,782,288	4,022,353	2,461,343,489	
Shtesa	1,165,500	-	-	1,165,500	
Pakësime	-	-	-	-	
Më 31 dhjetor 2017	67,704,348	2,390,782,288	4,022,353	2,462,508,989	
Shtesa	-	69,877,189	1,665,693	71,542,882	
Pakësime	-	-	(819,840)	(819,840)	
Më 31 dhjetor 2018	67,704,348	2,460,659,477	4,868,206	2,533,232,031	
<i>Zhvierësim i akumuluar</i>					
Më 1 janar 2017	-	(306,898,799)	(2,613,876)	(309,512,674)	
Shpenzime për vitin	-	(104,299,174)	(290,646)	(104,589,820)	
Pakësime	-	-	-	-	
Më 31 dhjetor 2017	-	(411,197,973)	(2,904,521)	(414,102,494)	
Shpenzime për vitin	-	(99,966,004)	(352,464)	(100,318,467)	
Pakësime	-	-	362,916	362,916	
Më 31 dhjetor 2018	-	(511,163,977)	(2,894,069)	(514,058,046)	
<i>Vlera e mbartur</i>					
Më 31 dhjetor 2017	67,704,348	1,979,584,315	1,117,831	2,048,406,494	
Më 31 dhjetor 2018	67,704,348	1,949,495,501	1,974,136	2,019,173,985	

HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

5. PARA NË ARKË DHE BANKË

	31/12/2018	31/12/2017
Para në arkë	151,040	90,997
Para në bankë në LEK	1,716,181	4,068,155
Para në bankë në valutë	25,459,415	6,276,675
Totali i mjeteve monetare	27,326,636	10,435,827

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga llogaritë në lekë dhe në euro që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në Shqipëri si dhe gjëndja e arkës në datën e raportimit.

6. LLOGARI TË ARKËTUESHME

	31/12/2018	31/12/2017
Llogari të arkëtueshme, klientë	16,378,088	36,548,270
Totali	16,378,088	36,548,270

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshme nga OSHEE për shitjen e energjisë elektrike.

7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

	31/12/2018	31/12/2017
Tatimi mbi fitimin	1,531,264	1,531,264
TVSH e kreditueshme	243,652,187	259,248,242
Të tjera parapagime dogane	3,243	-
Totali	245,186,694	260,779,505

8. KAPITALI I PAGUAR

Më 31 Dhjetor 2018 aksionarë të shoqërisë janë SOL S.p.A dhe EURO – AL Sh.p.k me 96.04% dhe 3.96% të kapitalit respektivisht. vlera e kapitalit është 1.444.108.950,00 LEK

Kapitali aksionar paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2018			Më 31 Dhjetor 2017		
	Nr. kuotave	%	Vlera e kapitalit	Nr. kuotave	%	Vlera e kapitalit
SOL	1	96.04%	1,386,877,050	1	96.04%	1,386,877,050
Euro-AL	1	3.96%	57,231,900	1	3.96%	57,231,900
	2	100%	1,444,108,950	2	100%	1,444,108,950



HYDROENERGY Sh.p.k
Rr Kavajes Dalje Kombinat
Vaqarr (Tirana) ALBANIA

HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

9. REZERVAT

Rezervat e krijuara nga shoqëria më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 kanë një vlerë prej 19.991.264 LEK.

10. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE

Të pagueshme ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	31/12/2018	31/12/2017
Llogari të pagueshme ndaj palëve të tjera	7,488,596	4,996,596
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	170,616,111	154,067,326
Totali	178,104,707	159,063,922

11. DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA

	31/12/2018	31/12/2017
Kontributet shoqërore e shëndetësore	113,296	101,262
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	76,627	23,331
Tatimi i mbajtur në burim	342,117	-
Detyrime ndaj punonjësve	-	796,486
Totali	532,040	921,079

12. HUA AFATGJATA

	31/12/2018	31/12/2017
Hua ndaj palëve të tjera	586,315,533	698,787,036
Hua ndaj palëve të lidhura	357,918,000	358,965,000
Totali	944,233,533	1,057,752,036



HYDROENERGY Sh.p.k
Rr Kavajes Dalje Kombinat
Vaqarr (Tirana) ALBANIA

HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

13. TË ARDHURAT

	31/12/2018	31/12/2017
OSHEE sh.a	151,078,000	86,265,141
Të tjera	1,270,000	32,841,217
Totali	152,348,000	119,106,358

Të tjera për vitin 2018 përfaqësojnë kompensim nga kompania e sigurimit.

Sipas kontratës konçesionare, Shoqëria paguan një tarifë konçesionare (concession fee) në bazë të prodhimit të energjisë e cila faturohet me notë krediti 2% të vlerës së energjisë së prodhuar për vitin përkatës. Duke qenë se sistemi i deklarimit të shitjeve në e-tax në deklarimin e FDP-ve e ngarkon pozitivisht këtë shumë, më poshtë jepen detajimet e shitjeve neto të energjisë elektrike.

	31/12/2018	31/12/2017
Shitje Bruto e energjisë elektrike	154,161,224	88,025,654
Fee konçesionare	(3,083,224)	(1,760,513)
Shitje Neto	151,078,000	86,265,141

14. SHPENZIME PËR PUNONJËSIT

	31/12/2018	31/12/2017
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	616,291	730,047
Pagat dhe shperblimet e personelit	4,623,234	5,390,378
Të tjera për punonjësit	120,240	-
Totali	5,359,765	6,120,425

HYDROENERGY Sh.p.k
Kavajës Dalje Kombinat
Vaqarr (Tirana) ALBANIA

HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

15. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

	31/12/2018	31/12/2017
Roje provate (security)	3,062,453	3,293,235
Konsulenca	2,977,626	2,627,976
Siguracione	2,112,617	2,278,728
Mirëmbajtje dhe riparime	1,898,615	4,855,320
Udhëtime e dieta	736,695	112,320
Taksa dhe tarifa vendore	713,779	425,895
Tatimi i mbajtur në burim	504,219	6,014,172
Utilitete (energji elektrike, ujë)	487,830	346,125
Shitje asetesh	92,924	-
Shërbime bankare	262,930	519,898
Qira	154,350	161,400
Shpenzime të tjera operative	149,990	127,787
Posta, telefoni, interneti	82,038	111,193
Gjoha dhe penalitete	-	24,000
Totali	13,236,066	20,898,048

16. SHPENZIME PËR INTERESA

	31/12/2018	31/12/2017
Fitime nga kursi i këmbimit	83,796,916	23,100,257
(Humbje nga kursi i këmbimit)	(339,571)	(189,951)
Totali i fitimeve nga kursi i këmbimit	83,457,345	22,910,306
Të ardhura nga interesat	-	20,456
Shpenzime për interesat	(70,128,984)	(89,357,055)
Totali i shpenzimeve për interesa	(70,128,984)	(89,336,600)
Totali shpenzimeve financiare, neto	13,328,361	(66,426,293)



HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

17. TATIM FITIMI

Tatimi mbi fitimin i parapaguar, nëse ka, mund të kompensohet nga shpenzimi për tatimin mbi fitimin, nëse ka.

	31/12/2018	31/12/2017
Fitimi / (humbja) për vitin	46,762,062	(78,928,229)
Shpenzime të pazbritshme	654,209	6,124,467
Fitimi / (humbja) tatimore për vitin	47,416,271	(72,803,762)
Humbje e mbartur	(26,041,700)	-
Tatimi mbi fitimin 15%	-	-
Humbja tatimore e mbartur	21,374,571	(72,803,762)

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e humbjes së mbartur:

	31/12/2018	31/12/2017
Humbje tatimore 2015	(33,517,645)	(33,517,645)
Humbje tatimore 2016	-	-
Humbje tatimore 2017	(72,803,762)	(72,803,762)
Humbje tatimore 2018	21,374,571	-
Humbje tatimore e akumuluar	(84,946,835)	(106,321,407)

18. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palë të lidhura me Shoqërinë konsiderohen:

- individë ose anëtarë të afërm të familjes së tyre të cilët: (a) zotërojnë kontroll mbi Shoqërinë bashkarisht ose individualisht, (b) kanë ndikim mbi veprimtarinë e Shoqërisë (c) janë anëtarë të manaxhimit të shoqërisë.
- entitete për të cilat plotësohet një nga kushtet: (a) entiteti dhe Shoqëria janë anëtarë të të njëjtit grup; (b) njëra nga entitetet është një filial ose një investim i një pale të tretë; (c) të dyja entitetet janë investim nga e njëjta palë e tretë; (d) një entitet është investim i një pale të tretë dhe ky i fundit është filial i tij; (e) entiteti është një plan përfitim pas-punësimit për punonjësit e Shoqërisë; (f) entiteti kontrollohet nga një individ që përmbush kriterin 1.



HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

18.1 Veprime në lidhje me aktivitetin

Shoqëria ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqërinë mëmë dhe shoqëri brenda grupit.

Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura paraqitet më poshtë:

<i>Të pagueshme te SOL S.p.A</i>	31/12/2018	31/12/2017
Tregëtare	170,616,111	154,067,326
Financiare	357,918,000	358,965,000
Totali	528,534,111	513,032,326

19. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas datës së pasqyrave financiare nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë



HYDROENERGY

Shenim Per Bilancin e HYDROENERGY 2018

Monza, 01 mars 2019

Te ardhurat nga veprimtaria e shfrytezimit (Faturimi): 151,078,000 Leke

Viti 2018 eshte i katerti vit i funksionimit te plote te Shoqerise me te dyja Centralet.

Prodhimi ka qene 17.6 milion kWh, me i larte se ai i vitit 2017, qe ishte 11.6 milion kWh (+ 51.7%). Viti 2018 u karakterizua nga reshje te konsiderueshme shiu gjate gjashte mujorit te pare, nderkohe qe prodhimi i ulet ne gjysmen e dyte te vitit ishte per shkak te reshjeve me te ulta dhe instalimit te portes se re te drenazhimit ne anen tjetere, ishte e detyrueshme te ndalonin centralet e prodhimit te energjise per muajt korrik, gusht dhe shtator.

Centralet kane punuar mesatarisht 4000 ore ne vit secili.

Faturimi total arriti ne 151,078,000 leke kundrejt 86,265,141 Leke (+ 75.1%).

Çmimi i shitjes se energjise elektrike per OSHEE u rrit me 15% ne 2018, nga 7.448 lek/ kWh qe ishte ne vitin 2017 u be 8.565 leke / kWh ne vitin 2018.

Gjate vitit, shoqeria Hydroenergy ka mare nga shoqeria e sigurimeve kompensim ne vleren prej 1,270,000 leke dhe eshte shitur nje asset me vlere prej 364,000 leke.

Pergjate vitit 2018, jemi perpjekur te mbledhin fondet e humbura (1,103,000 €) te dhene nga METE me 16 shkurt 2012 ne fondet e bashkepunimit Italo - Shqiptare te Ministrise se Mjedisit Italiane.

Shpenzime per aktivitetin kryesor: 13,236,066 leke

Krahasuar me vitin 2017 per shkak te shpenzimeve me te uleta te mirembajtjes dhe riparimit te puneve prej 1,898,615 leke (vs 4,855,320 leke te vitit 2017) dhe shpenzimeve me te ulta ne lidhje me tatimin ne burim te barabarte me 504,219 leke (rreth 6,014,172) leke te vitit 2017 per shkak te pageses se tatimit ne burim per interesin e paguar SOL spa).

Shpenzimet e personelit: 5,359,765 leke

Jane me te uleta se ne vitin 2017 (e barabarte me 6,120,425 leke) per gjithsej 7 punonjes (duke pefshire edhe dy administratoret), te njejta si ne 2017.

Shpenzimet financiare dhe financimet perkatese: 70,128,984 leke

Shpenzimet e interesit ishin 70,128,984 leke (krahasuar me 89,357,055 leke te vitit 2017), krahasuar me vitin 2017 pas rikapitalizimit te Shoqerise. Ne menyre te veçante, shpenzimet financiare prej 27,288,921 leke per huate e dhena nga SOL Spa dhe 42,840,063 leke per huane e dhene nga IMI (Gruppi INTESASANPAOLO). Nder te ardhurat financiare, 83,457,345 diferenca te kursit te kembimit jane regjistruar pas forcimit te kursit te kembimit te lekut kundrejt euros.

HYDROENERGY Sh. P. K.
Kombinat, Vaqarr
Tirane - Shqipëria
t +355 (0) 43 52877
f +355 (0) 43 52877
TVSH K9152701E
www.solworld.com



Matteo Fumagalli Romario

SOLGROUP
a breath of life